

PROTOKOLLI FAKULTATIV I PAKTIT NDËRKOMBËTAR PËR TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE

Miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 2200 A (XXI) të datës 16 dhjetor 1966

HYRË NË FUQI: më 23 mars 1976,
Në përputhje me nenin 9

Shetet palë të këtij Protokolli,

Duke pasur parasysh se, për t'i arritur mëtej qëllimet e Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (në tekstin e mëtejshëm: "Pakti") dhe zbatimin e dispozitave të tij, do të ishte e përshtatshme që të aftësohet Komiteti i të Drejtave të Njeriut, të formuar në pjesën e katërt të Paktit (në tekstin e mëtejshëm: "Komiteti"), për të marrë dhe shqyrtuar, ashtu siç parashikohet në këtë Protokoll, komunikimet që vijnë nga individët të cilët pohojnë se janë viktimë të shkeljes së cilavedo të drejta të parashikuara në këtë Pakt,

U morën vesh për sa vijon:

Neni 1

Çdo shtet palë i këtij Pakti që bëhet palë e këtij Protokolli njihë kompetencën e Komitetit për të marrë dhe shqyrtuar komunikimet që vijnë nga individët të cilët varen nga juridiksioni i tij, e të cilët pohojnë se janë viktimë të shkeljes nga ky shtet palë të cilavedo të drejta të parashikuara në këtë Pakt. Komiteti nuk do të pranojë kurrfarë komunikimi që ka të bëjë me një shtet palë të këtij Pakti, që nuk është palë e këtij Protokolli.

Neni 2

Sipas dispozitave të nenit 1, individët të cilët pohojnë se janë viktimë të shkeljes së cilavedo të drejta të parashikuara në këtë Pakt dhe që kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të brendshme në dispozicion mund t'i parashtrojnë një komunikim me shkrim Komitetit duke kërkuar që ta shqyrtojë.

Neni 3

Komiteti konsideron si të papranueshëm çdo komunikim anonim të paraqitur në bazë të këtij Protokolli, ose të cilin ai e quan si një shpërdorim të së drejtës për të paraqitur komunikime të tilla ose si të papajtueshëm me dispozitat e Paktit.

Neni 4

1. Sipas dispozitave të nenit 3, çdo komunikim që i paraqitet në bazë të këtij Protokolli Komiteti ia kalon shtetit palë të këtij Protokolli, për të cilin pohohet se ka shkelur çfarëdo dispozite të këtij Pakti.

2. Brenda gjashtë muajve në vazhdim, shteti në fjalë i paraqet me shkrim Komitetit shpjegimet ose deklaratat të cilat e sqarojnë çështjen duke treguar, kur është rasti, edhe masat që mund të ketë marrë për të rregulluar situatën.

Neni 5

1. Komiteti shqyrton komunikimet që merr në bazë të këtij Protokolli duke pasur parasysh të gjitha informacionet me shkrim që i janë parashtruar nga një individ dhe nga shteti palë i interesuar.

2. Komiteti nuk do të marrë në shqyrtim kurrfarë komunikimi të një individi pa u siguruar më parë se:

(a) Çështja e njëjtë nuk është duke u shqyrtuar nga një instancë tjetër ndërkombëtare për ta hetuar ose zgjidhur;

(b) Individu ka shteruar të gjitha mjetet juridike të brendshme në dispozicion. Ky nuk duhet të jetë rregull nëse procedurat sipas mjetit juridik zgjaten tej afateve të arsyeshme.

3. Komiteti mban mbledhje me dyer të mbyllura kur shqyrton komunikimet e parashikuara në këtë Protokoll.

4. Komiteti ia bën të njohura konstatimet e tij shtetit palë të interesuar si dhe individit.

Neni 6

Komiteti në raportin vjetor që e harton në përputhje me nenin 45 të Paktit përfshin edhe një përmbledhje të shkurtër të aktiviteteve të tij në kuadër të këtij Protokolli.

Neni 7

Në pritje të realizimit të objektivave të Rezolutës 1514 (XV) të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 14 dhjetor të vitit 1960 lidhur me Deklaratën për Dhënien e Pavarësisë Vendeve dhe Popujve Kolonialë, dispozitat e këtij Protokoll nuk e kufizojnë aspak të drejtën e peticionit që u njihet këtyre popujve nga Karta e Kombeve të Bashkuara si dhe nga konventa e instrumente të tjera ndërkombëtare që janë lidhur nën kujdesin e Kombeve të Bashkuara dhe institucioneve të tyre të specializuara.

Neni 8

1. Ky Protokoll është i hapur për nënshkrimin e çdo shteti që ka nënshkruar Paktin.
2. Ky Protokoll i nënshtrohet ratifikimit nga çdo shtet që ka ratifikuar Paktin ose që ka aderuar në të. Instrumentet e ratifikimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.
3. Ky Protokoll do të jetë i hapur për aderimin e çdo shteti që ka ratifikuar Paktin ose që ka aderuar në të.
4. Aderimi do të bëhet nëpërmjet depozitimit të një instrumenti të aderimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.
5. Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara informon të gjitha shtetet të cilat kanë nënshkruar këtë Protokoll ose që kanë aderuar në të, lidhur me depozitimin e çdo instrumenti të ratifikimit ose të aderimit.

Neni 9

1. Sipas kushtit të hyrjes së Paktit në fuqi, ky Protokoll do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara të instrumentit të dhjetë të ratifikimit ose të aderimit.
2. Për secilin prej shteteve që do të ratifikojë këtë Protokoll ose që do të aderojë në të pas depozitimit të instrumentit të dhjetë të ratifikimit ose të aderimit, ky Protokoll do të hyjë në fuqi tre muaj pasi ky shtet të depozitojë instrumentin e tij të ratifikimit ose të aderimit.

Neni 10

Dispozitat e këtij Protokollit zbatohen, pa asnjë kufizim dhe përjashtim, për të gjitha njësitë konstitutive të shteteve federative.

Neni 11

1. Çdo shtet palë i këtij Protokollit mund të propozojë një amendament dhe të depozitojë tekstin e tij pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Sekretari i Përgjithshëm ua kalon atëherë shteteve palë të këtij Protokollit të gjitha projektet e amendamenteve duke u kërkuar të shprehen nëse duan të thirret një konferencë e shteteve palë për të shqyrtuar këto projekte dhe për të votuar për to. Në qoftë se të paktën një e treta e shteteve shprehen në favor të thirrjes së Konferencës, Sekretari i Përgjithshëm e thërret Konferencën nën patronazhin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Çdo amendament i miratuar nga shumica e shteteve palë të pranishme dhe votuese në Konferencë i shtrohet për miratim Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

2. Këto amendamente hyjnë në fuqi pasi t'i ketë miratuar Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara dhe të jenë pranuar, në përputhje me rregullat e tyre kushtetuese përkatëse, me shumicën e dy të tretave të shteteve palë të këtij Protokollit.

3. Kur këto emendamente hyjnë në fuqi, ato bëhen të detyrueshme për ato shtete palë që i kanë pranuar, ndërsa shtetet e tjera mbeten të lidhura me dispozitat e këtij Protokollit dhe me çdo amendament të mëparshëm që i kanë pranuar.

Neni 12

1. Çdo shtet palë mund të denoncojë këtë Protokoll kurdoherë me një njoftim me shkrim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Denoncimi do të hyjë në fuqi tre muaj pasi Sekretari i Përgjithshëm të ketë marrë njoftimin.

2. Denoncimi nuk do të pengojë zbatimin e dispozitave të këtij Protokollit për çdo komunikim të parashtruar në bazë të nenit 2 para se denoncimi të hyjë në fuqi.

Neni 13

Pavarësisht nga njoftimet e parashikuara në nenin 8, paragrafin 5 të këtij Protokollit, Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara do të informojë të gjitha shtetet e përmendura në nenin 48, paragrafin 1 të Paktit:

(a) Për nënshkrimet e vëra në këtë Protokoll dhe për instrumentet e ratifikimit e të aderimit të depozituara në përputhje me nenin 8;

(b) Për datën kur ky Protokoll do të hyjë në fuqi në përputhje me nenin 9 dhe për datën kur do të hyjnë në fuqi amendamentet e parashikuara në nenin 11:

(c) Për denoncimet e bëra në përputhje me nenin 12.

Neni 14

1. Ky Protokoll, tekstet e të cilit në gjuhët kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle janë njësoj autentike, do të depozitohet në arkivat e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

2. Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara do t'u dërgojë nga një kopje të vërtetuar të këtij Protokollit të gjitha shteteve të përmendura në nenin 48 të Paktit.

(Unofficial version, 19 June, 2003)